

## NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata e Apelit e Kosovës** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Rasim Rasimi, kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi e Gani Zabeli, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, në çështjen penale kundër të akuzuarës V.S. Komuna e Istogut, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 e lidhur me par. 1.4 të Kodit Penal të Republikës Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së të dëmtuarës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë –Dega në Istog, P.nr.477/2016 të datës 30.01.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 17.03.2017, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

I. Përkitazi me ankesën e të dëmtuarës M.Xh. e sipas detyrës zyrtare, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë –Dega në Istog, P.nr.477/2016 të datës 30.01.2017 lidhur me mbikëqyrjen e dënimit të shqiptuar me gjobë në shumë prej 500(pesëqind)€ ndaj të akuzuarës V.S. i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, ashtu që mbikëqyrjen e dënimit të shqiptuar me kusht do ta bëjë Shërbimi Sprovues i Kosovës në Pejë.

II. Në pjesët tjera, aktgjykimi mbetet i pa ndryshuar.

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë–Dega në Istog, me aktgjykimin P.nr.477/2016 të datës 30.01.2017, të akuzuarën V.S. e ka shpallur fajtorë për kryerjen e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 lidhur me par.1 nënpar. 1.4 të KPRK-së dhe të akuzuarës i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) €, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e akuzuara nuk kryen vepër të re penale. E akuzuara obligohet që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 30€ në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e dëmtuara M.Xh. për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e atakuar me ankesë ta ndryshojë dhe të akuzuaraes ti shqiptoj dënim më të lart, dënim me burg efektiv.

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.318/2017 datë 13.03.2017, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e të dëmtuarës, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe ndaj të akuzuarës të shqiptohet një dënim më i lartë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

**- ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt komfor dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse e akuzuara në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 25.01.2017 e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Kolegji penal i kësaj Gjykate, duke e shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar sipas detyrës zyrtare, vlerëson se në rastin konkret aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje të ligjit penal në dobi të akuzuarës V.S. të cilën e ka shpallur fajtores për kryerjen e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 lidhur me par.1 nënpar. 1.4 të KPRK-së dhe të akuzuarës i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) €, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e akuzuara nuk kryen veprë të re penale, por nuk ka shqiptuar mbikëqyrjen e dënimit të shqiptuar. Prandaj, Gjykata e Apelit sipas detyrës zyrtare e ndryshoi aktgjykimin e ankimuar sa i përket mbikëqyrjes së dënimit të shqiptuar, të cilin do ta bëjë Shërbimi Sprovues i Kosovës në Pejë e me këtë eliminoi edhe shkeljen e ligjit penal nga neni 385 par.1 të KPRK.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, me ankesë e dëmtuara pretendon se Gjykata e shkallës së parë ndaj të akuzuarës ka shqiptuar dënim tejet të butë dhe qëllimi i dënimit nuk do të arrihet kur e akuzuara është dënuar me dënim me gjobë, dhe ka pasur bazë ligjore që e akuzuara të dënohet me dënim me burg efektiv, gjithë kjo mbështetet në provat që janë në shkresa të lëndës.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e të dëmtuarës për shqiptimin e një dënimi me burg efektiv, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenin 73 të KPRK-së, me ç'rast si rrethana lehtësuese ka vlerësuar se e akuzuara ka pranuar fajësinë, se është penduar për veprën e kryer, është ndier e përgjegjshme për veprimet e saj dhe ka shpreh keqardhjen për veprën penale që e ka kryer, dhe se më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, ndërsa rrethana rënduese nuk ka potencuar.

Kjo gjykatë, vlerësimin e këtyllë të rrethanave relevante të vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, në fakt në ankesë nuk ceket asnjë rrethanë që nuk është vlerësuar më parë nga gjykata e shkallës së parë, e që sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të ndikonte që të akuzuarit t'i

shqiptohet një dënim më i ashpër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Nga sa u tha më lartë në pajtim më dispozitën e nenit 403 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.295/16 me datë 17.03.2017**

**Bashkëpunëtori profesional**  
**Hysni Ismaili**

**Kryetari i kolegjit-gjyqtari**  
**Rasim Rasimi**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Shqipe Qerimi**

**Gani Zabeli**